

STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"TN Management" sh.p.k

(Inkorporuar edhe Akti i Themelimit)

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr. 9723 të datës 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, krijohet shoqëria tregtare "TN Management" sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI 1

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA , KOHEZGJATJA

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE DHE THEMELUESIT

1.1 Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar “TN Management” sh.p.k., me ortak të vetem:

- z. LORENC BEGAJ, lindur me 27.05.1962, në Gjirokaster, shtetas madhor e me zotesi të plote për të vepruar me nr. personal G20527045T

NENI 2

SELIA

2.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Sheshi "Karl Topia", Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Teknoprojekt, Shkalla Nr.2. Ap Nr.31.

2.2 Shoqëria mund të zgjerohet me adresa sekondare të veprimtarisë së saj, filiale etj., në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me ligjin në fuqi.

NENI 3

KOHEZGJATJA

3.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat kohor të pacaktuar.

NENI 4

VULA

4.1 Shoqëria do të ketë vulën ekskluzive të sajën, e cila prodhon autenticitet në nënshkrimet e shoqërisë.

NENI 5

OBJEKTI

5.1 Shoqëria do të ketë Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

5.2 Shoqëria ka për objekt aktiviteti si vijon:

- Ndertim
- Studime topo-gjeodezike dhe gjeodezike, rlevime në terrene dhe poligone, piketime objektësh, rruge dhe linja tensioni
- Turizem
- Energji e rinovueshme
- Import-eksport
- Hoteleri
- Agjenci turistike
- Agjenci transporti

5.3 Për shkak të nevojave të mëtejshme të shoqërisë në të ardhmen, objekti i veprimtarisë mund të zgjerohet në fusha të tjera të biznesit, për të cilat do ndiqen procedurat e brendshme të shoqërisë si dhe ato në institucionet përkatëse shtetërore lidhur me licencat, mbrojtjen e markave dhe patentave etj.

5.4 Shoqëria mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse; Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkeinvestitorë, pronarë tërësisht apo objektësh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike; të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tjerëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim me të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërisë ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

5.5 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejnë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmes me qëllim të përmbushjes ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KAPITULLI II

KAPITALI

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 200 (dyqind) Lek, i cili është kapital teresisht financiar dhe miratohet nga ortaku themelues, dhe ndahet në 1 (nje) kuote me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë të përcaktuar në pikën 6.2 të këtij neni;

6.2 Kapitali i ortakëve themelues është si më poshtë:

- Ortaku i vetëm z. LORENC BEGAJ, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 200 (dyqind) Lek, që përben 100% (njqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7

PJESËMARRJET NË KAPITALIN THEMELTAR

7.1 Pjesëmarrjet e ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohet në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

7.2 Të drejtat, përfshirë edhe të drejtat e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar.

7.3 Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" nënkuptojmë çdo akt tjetërsimi të kuotave, në kuptimin më të gjerë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu dhe të pjesëshme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to.

7.4 Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë në Asamble ose nëpërmjet letre rekomande, ofertën e marrë, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).

NENI 8

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

8.1 Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën nivelin e kapitalit fillestar të derdhur.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT

9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit fillestar;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

9.2 Ortakët mund të shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre të kapitalit. Shitja e kuotave tek të tretët bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim Asambleja e Ortakëve dhe nëpërmjet kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE

NENI 10

ORGANET DREJTUESE

10.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori

NENI 11

ORGANI VENDIMARRËS

11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, ortakët vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njeri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratim. Ortaket gëzojnë të drejtën të thërrasin Asamblenë e ortakëve në rastet dhe me shurnicat e përcaktuara në ligj.

11.2 Janë në çdo rast në kompetencë të Asamblese që vendos me mazhorancë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës kur janë prezent më shumë se 30% e kuotave të kapitalit themeltar, për vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme, si më poshtë:

- a) Emërtimin e shkarkimin e administratorit;
- b) Emërtimin dhe shkarldmin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar, duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
- c) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjen a dhe b;
- d) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

11.3 Jane në kompetencën e Asamblese së Ortakëve e cila vendos me votën në favor të 3/4 të ortakëve prezent që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, vendimet që kanë lidhje me :

- a) Miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
- b) Ndryshimet e këtij statuti;
- c) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- d) Ndryshimin e formës së shoqërisë apo riorganizimin e saj;
- e) Shpërndarjen e shoqërisë.

11.4 Asambleja mund të mblidhet në mënyrë të jashtëzakonshme kur e kërkojnë administratori apo më shumë se një e treta e ortakëve të shoqërisë.

Në mbështetje të nenit 88 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortakët kanë të drejtën për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 12

MBLEDHJA E ASAMBLESE

12.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, dt 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera, dhe çdo herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Takimi i rregullt i Asamblesë së Përgjithshme behet të paktën një herë në vit.

12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortakët në përputhje me nenin 12 të këtij statuti.

12.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në qoftë se, nga pasqyrat financiare vjetore apo prospektet e rezultateve të ndërmjetme, ekziston rreziku që fitimet e kompanive nuk i mbulojnë detyrimet e duhura për 3 muajt e ardhshëm.

12.4 Asambleja e Përgjithshme mblidhet kur shoqëria, brenda dy viteve të para të krijimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, asete me një vlerë mbi 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton nga deklaratat e fundit financiare të certifikuara.

12.5 Në rastet e parashikuara në pikat 12.3 dhe 12.4 të këtij neni, duhet t'i paraqitet Asamblese se Përgjithshme një raport i detajuar nga një kontabilist i autorizuar me licencë i pavarur.

12.6 Nëse Asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

NENI 13

THIRRJA E ASAMBLESE

13.1 Asambleja e ortakeve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakëve dhe vendimet e saj të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim. Asambleja e Ortakëve thirret me një njoftim me shkrim dërguar ortakëve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike.

13.2 Njoftimi me shkrim ose me e-mail, duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i komunikohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

13.3 Njoftimi për thirrjen e asamblesë është bërë me shkrim dhe do të dorëzohet për secilin ortak në adresën e regjistruar në regjistrin e ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.

13.4 Përveç sa me sipër, njoftimi për thirrjen e asamblesë mund të bëhet nëpërmjet dorëzimit të tij administratorit, ky i fundit ka përgjegjësinë e dorëzimit të këtij njoftimi, ortakeve.

13.5 Në numërimin shtatë ditësh nuk merret parasysh, dita e dorëzimit të njoftimit dhe dita e mbajtjes së mbledhjes.

13.6 Kur Asambleja nuk është mbledhur në mënyrën e përshkruar më lart, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se është e përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nga anëtarët nuk kundërshtojnë diskutimin e çështjeve në rend të ditës. Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të saj të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

13.7 Mbledhja e Asamblesë së ortakeve mund të mbahet edhe nëpërmjet video- konferencës ose telekonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes dhe t'u lejohej të ndjekin diskutimin, të marrin, të dërgojnë dhe të vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohe reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të vendosin, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve. Në prani të kushteve të mësipërme, Asambleja e Ortakëve konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj ose në vendin që tregohet në njoftimin e mbledhjes së saj. Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në Asamble në përpjesëtim me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar.

13.8 Ortakët mund të përfaqësohen në Asamble nga persona të tjerë nëpërmjet një autorizimi apo prokure të posaçme. Autorizimi apo Prokura është e vlefshme vetëm për asamblesë për të cilën lëshohet, të identifikuar sipas rendit të ditës gjithashtu përfshin takime pasuese me të

njëjtin rend dite. Ortakët nuk mund të përfaqësohen nga administratori i shoqërisë. Vota duhet të jetë e hapur ose gjithësi të shprehet me modalitete të tilla që të bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë në të njëjtin mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga Asambleja e ortakëve me shumicën e te pranishmeve, mbi propozim të administratorit.

NENI 14

AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

14.1 Vendimet e Asamblesë se Ortakeve pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes.

Administratoret janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

14.2 Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit.

14.3 Procesverbalit te Asamblesë i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbajtjen e takimit.

14.4 Procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortakët e pranishem dhe nga ai që e përpilon atë.

NENI 15

KUNDERSHTIMI I VENDIMEVE TE ASAMBLESE

15.1 Administratoret dhe secili ortak ka të drejtë të ankohet për vendimet e asamblese pranë Gjykatës së Shkalles së Parë, ku është selia e kompanise, nëse vendimet janë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

15.2 Ankimi, i përshkruar në paragrafin e mëparshem, drejtohet kundër shoqërisë dhe duhet të dorëzohet brenda 3 (tre) muaj nga vendimi.

15.3 Nëse vendimi kundërshtohet nga ana e administratorit të shoqërisë, kjo e fundit emëron një përfaqësues te saj në gjykatë.

15.4 Gjykimi i pavlefshmërisë ka efekt në lidhje me të gjithë ortakët dhe administratoret.

15.5 Për raste që nuk rregullohen në këtë statut do aplikohen dispozitat ligjore.

NENI 16

ADMINISTRIMI

16.1 Asambleja e Ortakeve ka të drejtë të vendosë nëse administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 2 (dy) dhe maksimumi 5 (pese) administratorë.

16.2 Administrimi i shoqërisë i cili konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, i besohet administratorit të vetëm ose

Këshillit Administrativ. Ne rastin e Këshillit Administrativ secili nga administratorët është i detyruar të informojë Këshillin për çdo veprim të kryer dhe në rast kundërshtish vendos Asambleja e Ortakeve.

16.3 Administratori i vetëm ose Administratorët (nëse janë emeruar qëndrojnë në detyre 5(pese) vjet, me të drejtë riemërimi, përveç nëse shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve apo rastet e doreheqjes.

16.4 Kushdo që administron shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe të tretëve për shkelje të mundshme të ligjit, statutit dhe për shkelje të tjera të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.5 Në rast të administrimit me Këshill Administrimi, ky mund të zgjedhë brenda tij President dhe një Administrator të Deleguar. Presidenti i Këshillit të Administrimit duhet të thërrasë Këshillin të paktën një herë në dy muaj dhe të njoftojë Këshillin e Administrimit për mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratoreve, Presidenti duhet të thërrasë Asamblenë e Ortakeve, e cila mund të vendosë në lidhje me kundërshtitë.

16.6 Në rastin e Këshillit Administrativ, administratorët mund të veprojnë bashkë ose veç e veç. Në çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratoreve këta i drejtohen Asamblesë së ortakeve, e cila mund të zëvendësojë Këshillin e Administrimit e të emërojë administratore të tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakeve me votën pro të ortakeve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bërë pa arsye të drejte, administratori mund të kërkojë dëmshpërblim financiar.

16.7 Në rastin e doreheqjes së një administratori, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet të thirret Asambleja e Ortakeve për emërimin e administratorit të ri, në rast se ky vendim nuk merret në të njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.

Shoqëria e themeluar do të administrohet nga një administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjidhje.

16.8 Me themelimin e shoqërisë emërohet **Administrator ortaku i vetëm Z. LORENC BEGAJ**, lindur më 27.05.1962, në Gjirokaster, shtetas madhor e me zotësi të plote për të vepruar me nr. personal G20527045T (në detyrë për 5 vjet me të drejtë rizgjidhje).

NENI 17
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

17.1 Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë së Ortakëve.

17.2 Administratori gëzon të drejta të kufizuara në lidhje me administrimin e llogarive rrjedhëse të shoqërisë, vetëm ortakët e shoqërisë kanë të drejtën për kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni që e vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë.

17.3 Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka të drejtë që ta përfaqësojë atë në marrëdhëniet me të tretët.

17.4 Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes së veprimeve të mëposhtme:

- a) Përgatit dhe harton inventarin, të llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, në mbyllje të çdo viti financiar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë së Ortakëve për miratim;
- b) Hartimin e projekteve të bashkimit ose të ndarjes së shoqërisë;
- c) Të informojë asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rëndësi për shoqërinë;
- d) Të raportojë përpara Asamblesë së Ortakëve mbi faktet që mund të kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
- e) Administratorët mund të delegojnë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
- f) Të thërrasë Asamblye të Ortakëve në rastet e parashikuara me ligj;
- g) Si dhe çdo të drejtë tjetër e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit të shoqërisë.

NENI 18

PERFAQESIMI I ADMINISTRATORIT

18.1 Administratori ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim. Ai mund të caktojë avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta apo kategori aktesh.

18.2 E drejta e firmes së shoqërisë mund të ushtrohet edhe nga personat të cilëve u është deleguar kjo e drejtë brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

18.3 Administratori ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të funksioneve si dhe një shpërblim vjetor të përcaktuar nga Asambleja e Ortakeve në momentin e emërimit ose me vendim të posaçëm.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR**

NENI 19 **VITI FINANCIAR**

19.1 Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj në organet tatimore, ndërsa për vitet në vijim nga data 1 janar deri me 31 dhjetor të çdo viti.

19.2 Në fund të çdo periudhe të ushtrimit të aktivitetit hartohet bilanci kontabel, brenda afateve dhe konform ligjeve në fuqi.

19.3 Dokumentet e kontabilitetit, të shoqëruar nëse është e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicionin e tyre pranë selisë së shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së Mbledhjes së Asamblesë.

19.4 Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse të saj si dhe librat kontabël në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave të tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë

19.5 Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20 **MARRËDHËNIET E PUNES**

20.1 Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave të punës dhe konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI 21 **FITIMET**

21.1 Koha, menyra dhe shuma e fitimit që shpërndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakeve të shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë

NENI 22 **FINANCIMI I ORTAKEVE**

22.1 Shoqeria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.

NENI 23

MBYLLJA E AKTIVITETIT

23.1 Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakeve të shoqërisë kur:

- a) Veprimtaria e shoqërisë është negative;
- b) Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
- c) Shpërndahet me vullnet të ortakëve;
- d) Riorganizohet në një formë tjetër;
- e) Si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

NENI 24

LIKUIDIMI

24.1 Kur verifikohet një nga shkaqet e parashikuara në Nenin 23 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakeve cakton një ose më shumë likuidatorë të cilët do të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për likuidimin e saj, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve.

24.2 Në rast se kapitali i shoqërisë do të jetë i pamjaftueshëm, ortakët e shoqërisë kanë detyrimin për të derdhur kuotat e tyre deri në nivelin e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar.

NENI 25

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

25.1 Në rast se lind një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë ortakëve, keta të fundit do të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen përmes konsultimit miqësor. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda një periudhe të arsyeshme, atëherë çështjet e pazgjidhura mund të paraqiten për ndërmjetësim në përputhje me rregullat ligjore të ndërmjetësimit sipas ligjeve të Anglisë dhe Uellsit. Nëse ndërmjetësimi nuk është i suksesshëm në zgjidhjen e të gjithë mosmarrëveshjes ose nuk është i mundur, çdo çështje e pazgjidhur do të paraqitet për arbitrazh përfundimtar dhe detyruet në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit. Vendimi i arbitrit do të jetë përfundimtar, dhe gjykimi mund të vendoset mbi të nga çdo gjykatë që ka juridiksion brenda Anglisë dhe Uellsit.

25.2 Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mund të fillohet nga cilido prej ortakëve me dorëzimin e njoftimit me shkrim ("Njoftimi për Mosmarrëveshje") për të gjithë ortakët e tjerë. Njoftimi për

Mosmarrëveshje do të specifikojë mosmarrëveshjen që do të ndërmjetësohet ose arbitrohet, çështjet e faktit dhe ligjit që do të përcaktohen dhe ndërmjetësuesin ose arbitrin e propozuar.

25.3 Çdo ortak mund të kundërshtojë një ndërmjetës të propozuar dhe të propozojë një alternativë duke dorëzuar një njoftim me shkrim të kundërshtimit për të gjithë ortakët e tjerë brenda 7 ditësh biznesi nga marrja e Njoftimit për Mosmarrëveshje. Të gjithë ndërmjetësuesit e propozuar do të caktojnë së bashku një ndërmjetës. Nëse ndërmjetësuesit e propozuar nuk arrijnë të bien dakord për një ndërmjetës, çdo palë në mosmarrëveshje mund t'i drejtohet një Gjykate në Angli për caktimin e një ndërmjetësi.

25.4 Çdo ortak mund të kundërshtojë një arbitër të propozuar dhe të propozojë një alternativë duke dorëzuar një njoftim me shkrim të kundërshtimit për të gjithë ortakët e tjerë brenda 7 Ditëve të Biznesit nga marrja e Njoftimit për Mosmarrëveshje. Të gjithë arbitrat e propozuar do të caktojnë së bashku një arbitër. Nëse arbitrat e propozuar nuk arrijnë të bien dakord për një arbitër, çdo palë në mosmarrëveshje mund të aplikojë në një Gjykatë në Angli për caktimin e një arbitri.

25.5 Nëse asnjë ortak nuk kundërshton me njoftim me shkrim ndërmjetësuesin ose arbitrin e propozuar brenda 7 ditësh biznesi nga marrja e Njoftimit për Mosmarrëveshje, ndërmjetësuesi ose arbitri i propozuar do të konsiderohet i miratuar.

NENI 26 **DISPOZITA FINALE**

26.1 Ky Statut u hartua ne **2 (dy)** kopje me të njëjtën vlerë juridike dhe hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e saj nga palet.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË "TN MANAGEMENT" SH.P.K

Z. LORENC BEGAJ

Tiranë më 15/09/2024